



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:282646
Datë: 27.05.2022
Numri i dokumentit: 03065900

CP.nr.152/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala, duke vendosur në lëndën përbarimore të kreditorit N.N., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Dardan Morina, avokat në Prizren, kundër debitores D.K.A. në Gj., për shkak kompensimin të shpenzimeve të ushqimit, me vlerë të kredisë 988,00euro, jashtë seancës, me 27 maj 2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore, e udhëhequr sipas shenjës CP.nr.152/2021, e iniciuar nga kreditorja e përbarimit: N.N., nga Gj., kundër debitores D.K.A. në Gj., për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitorja.

A r s y e t i m

Kreditori i përbarimit N.N., nga Gj., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Dardan Morina, avokat në Prizren, ka paraqitur propozimin për përbarim në bazë të dokumentit ekzekutiv Aktgjykimit C.nr.1037/19 datë 20.11.2020 i marrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, i ekzekutueshëm nga 23.02.2021, kundër debitores D.K.A. në Gjakovë dhe i kanë propozuar kësaj gjykatë që të lejoj përbarimin për shkak kompensimin të shpenzimeve të ushqimit, me vlerë të kredisë 988,00 euro të debitorit ndaj këtu kreditorit.

Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përbarimit, me aktvendimin CP.nr.152/2021, datë 18.03.2021, ka lejuar përbarimin ndaj debitores D.K.A. në Gjakovë.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP.nr.152/2021, datë 18.03.2021, ka marrë formën e prerë me datë 10.06.2021, gjykata ka nxjerrë urdhër për ekzekutim, me të cilin e ka urdhëruar Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorës D.K.A., të bëjë bartjen e mjeteve sikurse në urdhrin për ekzekutim CP.nr.152/2021, datë 07.10.2021 në llogari të autorizuarit të kreditorit, avokatit Dardan Morina.

I autorizuari i kreditorit, me parashtresën e datës 29.12.2021, ka njoftuar gjykatën se Thesari i Kosovës, ka vepruar sipas urdhrit të Gjykatës duke i ka ekzekutuar mjetet për destinim për kreditorët, duke theksuar se procedura ka përfunduar në tërësi.

Meqenëse kreditori përmes të autorizuarit të tij e ka njoftuar Gjykatën, se Thesari i Kosovës ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
CP.nr.152/21, me 27 maj 2022

GJYQTARJA
Mirjeta Shala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të parashtrohet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.